

Feith - Konferenca e donatorëve është shenjë e përkushtimit të BE-së në Kosovë

Pieter Feith, Përfaqësues Special i BE-së në Kosovë, sot mbajti fjalimin qendror në hapjen e Konferencës së Donatorëve për Kosovën të organizuar nga Komisioni Evropian në Bruksel. Konferenca ka për qëllim marrjen e premtimeve nga donatorët ndërkombëtar për zhvillimin socio-ekonomik të Kosovës dhe për krijimin e kushteve për zhvillim, investime dhe vende pune për të gjitha komunitetet në Kosovë.

“Jam i lumtur që marr pjesë në këtë konferencë të shumë-nevojitur të donatorëve për Kosovën në cilësinë time si Përfaqësues Special i BE-së në Kosovë. Ajo zë vend të rëndësishëm në kontekstin e rritjes së përkushtimit të gjithëmbarshtëm të BE-së për të mbështetur progresin në Kosovë”, tha Feith.

Z. Feith uroi Qeverinë e Kosovës për Kornizën e saj Afatmesme të Shpenzimeve dhe theksoi se përqendrimi duhet të jetë në krijimin e strukturave të qëndrueshme. Ai tha:

“Në Kosovë, ndikimi i mundshëm i suksesit ose i dështimit i kalon për së tepërmi përmasat e zakonshme. Zhvillimi ekonomik jo vetëm që do ta rrisë prosperitetin, por gjithashtu do të përmirësojë mirëkuptimin social”.

Z. Feith theksoi se beson shumë që Kosova do t'i shfrytëzojë më së miri mjetet e premtuara sot dhe që bashkësia ndërkombëtare do të punojë së bashku me autoritetet e Kosovës për të siguruar implementimin adekuat të fondeve të reja në përfitim të të gjithëve në Kosovë.

Ai gjithashtu theksoi se nevojiten përpjekje të veçanta, të përbashkëta ndërmjet bashkësisë ndërkombëtare dhe autoriteteve të Kosovës për t'i dhënë siguri komunitetit serb në Kosovë. Shumë nga shqetësimet e tyre të përditshme do të adresohen përmes decentralizimit që do të bëhet në mbarë Kosovën e që do ta afrojë vendimmarrjen më afër qytetarëve. Z. Feith tha:

“Megjithatë, ky është një proces i gjatë. Prandaj, do të dëshiroja të theksoj nevojën për projekte të menjëhershme që kanë për pikësynim përmirësimin e standardit të jetesës në zonat ku jetojnë komunitetet jo shumicë”.

(fund)



Shënim për editorët:

Për më shumë informata mbi Konferencën e Donatorëve për Kosovën, luteni të shihni kumtesën për shtyp të Komisionit Evropian në <http://ec.europa.eu/enlargement/>

Informatë mbi historikun e Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian (EUSR) në Kosovë:

Objekti i Bashkimit Evropian në Kosovë është të përkrahë dhe ndihmojë autoritetet e Kosovës në zhvillimin e një Kosove stabile, të qëndrueshme, paqësore dhe shumetnike që bashkëpunon në mënyrë paqësore me fqinjët e saj në rajon. Për të promovuar këto objektivë, Këshilli i Bashkimit Evropian emëroi Pieter Feithin si Përfaqësues Special të BE-së (EUSR) në Kosovë më 4 shkurt 2008.

Mandati i tij është:

- të ofrojë këshillimin dhe përkrahjen e Bashkimit Evropian për Qeverinë e Kosovës në procesin politik drejt integritimit evropian
- të promovojë koordinimin e përgjithshëm të pranive të BE-së në Kosovë, si p.sh. Zyrën Ndërlidhëse të Komisionit Evropian dhe Misionin e Sundimit të Ligjit EULEX (shih www.euinkosovo.eu)
- të sigurojë njëtrajtshmëri dhe koherencë në veprimet e BE-së që kanë për synim publikun
- të ofrojë këshillim politik lokal për Drejtuesin e Misionit të BE-së për Sundimin e Ligjit, EULEX në Kosovë
- të kontribuojë në zhvillimin dhe konsolidimin e respektit për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut në Kosovë.

Z. Feith njëherësh mban edhe mandatin e veçantë si Përfaqësues Ndërkombëtar Civil (ICR) në Kosovë.

Për më shumë informata mbi EUSR-në në Konferencën e Donatorëve për Kosovën, luteni të thërrisni zëdhënësen e EUSR-së Julia Rueter + 377 509 760 ose të vizitoni www.eusrinkosovo.eu.